



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.380/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Rrustem Thaqi dhe Ferki Rexhepi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e koalicionit NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) – Divizionit për Shërbimin e Votuesve, të datës 11.10.2019, për shkak të procesimit të votave të pa rregullta të ardhura nga Serbia përmes postës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 30.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e pasafatshme ankesa Anr. 380/2019 e datës 28.10.2019, e paraqitur nga koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) – Divizionit për Shërbimin e Votuesve, të datës 11.10.2019, me të cilën ka kërkuar që të anulohen si të pa rregullta fletëvotimet e ardhura nga Serbia, përmes postës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019.

A r s y e t i m

Me datën 28.10.2019, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.380/2019, të paraqitur nga koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, kundër vendimit të KQZ-së, Divizionit për Shërbimin e Votuesve të datës 11.10.2019, me të cilën pretendon se vendimi në fjalë është në kundërshtim me nenin 97 par. 1 dhe 2 të LZP-së, lidhur me nenet 4.3 dhe 4.4 të Rregullës Zgjedhore Nr.03/2013, sa i përket mënyrës së rregullt të pranimit përmes postës së votuesve individual me të drejtë vote e të cilët jetojnë jashtë Kosovës, duke propozuar që PZAP-i, të aprovojë ankesën në tërësi si të bazuar në pajtim me dispozitat e LZP-së në fuqi, duke i shpallur të parregullta/pavlefshme 3.782 zarfe dhe të obligojë KQZ-në që këto pako të ardhura/bartura nga Serbia përmes dy personave të paautorizuar nga KQZ-ja, njëri nga të cilët i pa identifikueshëm, në kundërshtim me dispozitat e lartëcekura ligjore, t'i heq nga QNR dhe t'i veçoj nga votat e rregullta, dhe të mos e shpall rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të 06 Tetorit 2019, pa hequr nga QNR pakot nga Serbia. Se bartja dhe dorëzimi i këtyre pakove është bërë nga persona të paautorizuar nga KQZ-ja, është konstatuar edhe nga KQZ-ja, dhe se mundësia e falsifikimit, manipulimit të pakove, ka ekzistuar nga vendi i origjinës e deri në dorëzim, në postën Nr.6 në Prishtinë, dhe kjo mënyrë e dërgimit të pakove me fletëvotime nuk parashikohet me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së apo të Rregullave Zgjedhore në Republikën e Kosovës. Më tej,

paraqitësi i ankesës ka theksuar se pakot e transportuara ilegalisht nga persona të paautorizuar nga KQZ-ja, në postën Nr.6 në Prishtinë, nuk kanë vulë dhe as pullë postare të postës së origjinës, se nga cila adresë janë nisur, për tu përputhur adresat personale për votim individual personal, që do të duhej të ishte ndonjëra nga postat e Serbisë, duke pasur parasysh faktin se votuesit kanë votuar në Serbi, që paraqet shkelje të nenit 4.3 të Rregullës Zgjedhore Nr.03/2013. Me propozim për PZAP, që duke marrë parasysh situatën ligjore të krijuar pas aktgjykimit të Gjykatës Supreme, rasti A.A-UZH nr.19/2019, se edhe heshtja e KQZ-së, konsiderohet vendimmarrje në procesin zgjedhor, ta rishqyrtojë ankesën e koalicionit NISMA-AKR-PD, që lidhet me votimin jashtë vendit – pakot e ardhura nga Serbia.

Në përgjigje në ankesë të datës 29.10.2019, KQZ-ja, ka theksuar se pretendimet ankimore të paraqitura nga ana e koalicionit NISMA-AKR-PD, në ankesën Anr.380/2019 të datës 28.10.2019, janë të njëjta me ato të paraqitura nga ky subjekt politik në ankesën Anr.378/2019 të datës 24.10.2019, dhe kjo çështje tashmë është gjë e gjykuar – res judicata, dhe sipas parimit *ne bis in idem*, nuk mund të vendoset dy herë për të njëjtën çështje. Sa i përket kërkesës për hetim të materialit zgjedhor në QNR, KQZ-ja, ka njoftuar se kjo kërkesë mund të realizohet pas konstatimit të pranueshmërisë dhe lejueshmërisë së ankesës nga PZAP-i, lidhur me ankesën e paraqitur për herën e dytë e për të njëjtën çështje. Ndërsa sa i përket përshkrimit të procedurave që janë zhvilluar përkitazi me këto fletëvotime, KQZ-ja, ka qëndruar pranë përgjigjes së dërguar më datë 25.10.2019, lidhur me ankesën Anr.378/2019, në të cilën ka sqaruar anën procedurale të dorëzimit të fletëvotimeve që janë objekt i kësaj çështje juridike, e të cilën së bashku me vendimin e PZAP-it, të evidentuar si Anr.378/2019, i ka bashkangjitur kësaj ankese, në formë të kopjes fizike.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e ankesës, gjeti se :

Ankesa është e pasafatshme

Paneli pasi që e vlerësoj afatshmërinë e ankesës gjetiu se e njëjta është e pas afatëshme nga se ankuesi i referohet parregullsisve në QNR, ku mundet të paraqitet ankesë në PZAPA brenda 24 orëve, nga ndodhja e shkeljes së supozuar, nga kjo rezulton se njëjta është paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, ku përcaktohet se *"Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it, brenda njëzetekatër (24) orëve nga ndodhja e shkelje së supozuar"*, si dhe nenit 5 par. 5 të Rregullës Nr. 02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, i cili përcakton se: *"Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga shkelja e supozuar"*.

Paneli po ashtu vlerësoj se ankesa e koalicionit NISMA-AKR-PD, është e pas afatëshme, edhe në bazë të nenit 122.1 të LZP-së, i plotësuar dhe i ndryshuar me Ligjin Nr.03/L-256, pasi që e njëjta është parashtruar me datë 28.10.2019, për faktin se, ankesë mundë të parashtroj pala me interes ligjor në PZAP-ë , ndaj vendimeve të KQZ , në afat prej 24 orëve, e që në rastin konkret ky afat nga ankuesi nuk është respektuar.

Në këtë kuptim nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se parashtruesi ankesën e ka paraqitur pranë PZAP-it me datë 28.10.2019, ndërsa afati prej njëzetekatër (24) orëve nga momenti kur ka ndodhur shkelja e supozuar në ankesë ka qenë me datë 12.10.2019, që do të

thotë se ankuesi, ankesën e ka parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5 të Rregullës Nr.02/2015, për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, andaj Paneli vlerësoi se ankesa e koalicionit NISMA-AKR-PD, në raport me vendimin e KQZ-së, Divizionit për Shërbimin e Votuesve të datës 11.10.2019, është e pasafatshme.

Meqenëse ankesa është e pasafatshme, Paneli nuk i shqyrtoi pretendimet tjera ankimore, pasi nuk u lëshua në vendosjen meritore në raport me këto pretendime.

Sa i përket bazës, në të cilën paraqitësi i ankesës i ka bazuar pretendimet e tija kur ka kërkuar nga PZAP-ja, që të rishqyrtohet ankesa e koalicionit NISMA-AKR-PD, që lidhet me votimin jashtë vendit – paket e ardhura nga Serbia, Paneli konstatoi se koalicionit NISMA-AKR-PD fare nuk ka ushtruar ankesë ndaj vendimit të PZAP-it, me të cilin është hedhur ankesa e tyre. Ndërsa, vendimi evidentuar si Anr.375/2019, nuk ka elemente të njëjta me ankesën Anr.380/2019, andaj edhe nuk ka bazë që për të dy këto ankesa të vendoset sipas një standardi të krijuar sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme, rasti A.A-UZH nr.19/2019, sepse secili rast trajtohet veç e veç dhe secili rast i ka karakteristikat e veta të veçanta ashtu siç është edhe në rastin konkret.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lart e në kuptim të nenit 115 par.1 të LZP-së, dhe nenit 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.380/2019 më datë 30.10.2019

Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa.